



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: 10.07 20 25		
Prilbjen:		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-hod/02-34949		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e kryetarit të komunës

Datë:	10.07.2025
Për:	Z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	Z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës Z. Latif Ramadani – Drejtor për Buxhet dhe Financa
Nga:	Zyra për Informim
Lënda:	Raporti i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e KAB për vitet 2026-2028


Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 paragrafi 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 Qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021, si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, përfaqësuesit nga komuna, konkretisht nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kanë mbajtur dëgjime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028 me qytetarët e vendbanimeve të ndryshme të Lipjanit.

RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE KAB 2026-2028



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



Përmbajtja

1. Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit 2025-2027..	4
2. Ecuria e procesit.....	5
3. Dëgjimi Buxhetor me Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe Komitetet tjera.....	6-7
4. Dëgjimi Buxhetor me gratë dhe shoqatat e grave.....	8
5. Dëgjimi Buxhetor me organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit.....	9-10
6. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave.....	11
7. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Gadimes.....	12-13
8. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Grackës së Vjetër – komunitetet jo shumicë.....	14
9. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Dobrajës së Madhe.....	15
10. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Krojmirit.....	16
11. Dëgjimi Buxhetor nga kuvendi me kuvendaret, anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të dhe kryetarët e këshillave të fshatrave.....	17
12. Konkluzionet.....	18-19



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIFIKIMIT TË
PROJEKT BUXHETIT 2026-2028**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026-2028, në përbërje si vijon:

1. Latif Ramadani, Drejtor në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Visar Kozhani, Zyrtar në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtar,
3. Alban Bytyqi, Zyrtar financiar në QKMF, anëtar,
4. Ismet Haziri, Zyrtar në Drejtoratin për Arsim, anëtar dhe
5. Ferdian Shala, Zyrtar në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar.

**Neni 2
Detyrat e Grupit Punues**

Grupi punues ka për detyrë hartimin e projekt planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026-2028 si dhe organizimin e degjimeve buxhetore në Komunën e Lipjanit. Grupi punues bënë vlerësimin e kërkesave të pranuar nga qytetarët dhe vendos cilat kërkesa pranohen dhe cilat refuzohen. Grupi punues duhet të hartojë planin e punës dhe të caktoj orarin e mbajtjes së degjimeve buxhetore duke mbajtur procesverbal dhe duke hartuar raport të punës së kryer të gjitha detyrat e hartimit të planifikimit të buxhetit për vitin 2026-2028 dhe organizimin e degjimeve buxhetore do të bëjë konform dispozitave të parapara ligjore që janë në fuqi. Po ashtu në fund të hartojë raportin nga degjimet buxhetore për ta dërguar në Kuvendin e Komunës. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e degjimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

**Neni 3
Hryja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-8994
Lipjan, më 26.02.2025

KRYETARI I KOMUNES
Imri Ahmeti



Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhim me Platformën e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit, në harmoni me ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, ka publikuar në faqen e internetit të komunës njoftimin lidhur me orarin e mbajtjes së këtyre takimeve, si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit në facebook, shih linket. ↓

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore KAB, 2026-2028

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Degjimet-Buxhetore-per-KAB-2026-2028.pdf>

<https://www.facebook.com/share/p/172eydXyx7/>

<https://www.facebook.com/share/p/1D1tB2mZCr/>

Po ashtu, në faqen e internetit tek konsultimet publike, është publikuar edhe projekt-buxheti, ku qytetarët kanë pasur mundësi të japin komentet lidhur me Planifikimin e projekt-buxhetit për vitet 2026-2028. Shih linkun <https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/KAB-per-Kuvend-Qershor-2025.pdf>

Njoftimi për diskutim publik është shpallur në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna. Po ashtu, palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën për mbajtjen e takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik projekt-buxheti për vitet 2026-2028.

Dëgjimi i parë publik lidhur me planifikimin e buxhetit është mbajtur me anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë e Financa, Komitetin për Komunitete, dhe komitete të tjera. Pastaj ka vazhduar me fokus grupet e veçanta si: Gratë dhe shoqatat e grave, organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, dhe fermerët e Komunës së Lipjanit. Ndërsa dëgjimet kanë vazhduar me banorët e qytetit të Lipjanit, kryetaret e këshillave të fshatrave dhe me banorët e fshatit Gadime, më pas është vazhduar me organizimin e dëgjimeve buxhetore në fshatrat Grackë e Vjetër (komunitetet jo shumicë) Dobrajë e Madhe si dhe Krojmir.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, para të pranishmëve fillimisht ka elaboruar projekt-buxhetin për vitet 2026-2028 dhe ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë dalë nga këto takime. Ai po ashtu ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë sa më shumë në këto takime, sepse kanë rëndësi të veçantë dhe janë mundësia më e mirë për përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, mori pjesë në dëgjimet buxhetore, duke shprehur përkushtimin për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Ai inkurajoi qytetarët që të jenë pjesëmarrës aktivë në këto takime dhe të parashtrojnë kërkesat e tyre, me qëllim planifikimin e buxhetit komunal në përputhje me prioritetet e qytetarëve.

Ndërsa Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Daut Azemi, ka organizuar një dëgjim të veçantë buxhetor me anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete, komitetet e tjera përcjellëse të kuvendit komunal, shoqërinë civile si dhe kryetaret e këshillave të fshatrave, me të cilët ka bashkëbiseduar rreth projekt-buxhetit për vitet 2026-2028.

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitet si dhe Komitetet tjera".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	1. Kërkoj investime në furnizimin me ujë të pijshëm dhe sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza? 2. Kërkoj bashkëpunim me Prishtinën për ndërtimin e një impianti të përbashkët për trajtimin e ujërave të zeza? 3. Kërkoj përfshirjen e ndriçimit publik, trotuareve dhe asfaltimit të rrugëve dytësore në buxhet? 4. Kërkoj zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Topliqan? 5. Ndërtimin e rrethojave të shkollës dhe asfaltimin e rrugicave në këtë fshat? 6. E konsideroj projektin e rrugës Topliqan-Kojnsk si të domosdoshëm? 7. Ndriçim publik dhe asfaltim të rrugicave në Kojnsk dhe Rubofc? 8. Ngriti shqetësimin për çështjet pronësore në lagjen "Akllapti" dhe kërkoj ndërhyrje minimale në shtruarjen e rrugëve? 9. Ndërtimi i një objekti të ri shkollor në qytet? 10. Ngriti si shqetësim rritjen e nivelit të ujit në lagje për shkak të urës mbi hekurudhë?	1. Kërkesa e pranuar pasi që komuna e Lipjanit ka parapa investim në rrjetin e ujësjellësit në fshatrat si Kraishtë, Ribar i Madhe, Zllakuqan, Hallaq i Madh, Bujan, Grackë e Vogël, Bregu i Zi dhe Topliqan. 2. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit do ti shikoj të gjitha mundësit e bashkëpunimit me Prishtinën për ndërtimin e përbashkët të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza. 3. Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndriçim publik në disa rrugica apo rrugë dytësore. 4. Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit ka parapa investim në rrjetin e ujësjellësit në Topliqan. 5. Kërkesa e pranuar pasi që komuna e Lipjanit ka parapa investim në rregullimin e oborreve të shkollave si dhe asfaltimin e rrugicave për fashitin Topliqan. 6. Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit ka parapa investim në rrugën Kojnsk-Topliqan. 7. Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e rrugicave në Kojnsk dhe Rubofc. 8. Kërkesa nuk pranohet pasi që komuna e Lipjanit e ka të pamundur me investua në rrugët të cilat kanë problem pronësore. 9. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e një shkolle në qytet. 10. Kërkesa nuk pranohet pasi që zona në fjalë është nën kompetencë të ministrisë për menaxhimin e hekurudhave dhe komuna e Lipjanit nuk ka te drejt të ndryhej.	F M T 6 12 18	10.06.2025 Salla e Kuvendit Komunal Ora 13:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitet, si dhe komitetet tjera".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Gratë dhe shoqatat e grave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	- Kërkoj shqyrtimin e mundësisë për shpronësimin e pronave private në lagjen Akllap, me qëllim asfaltimin e rrugëve që konsiderohen të rëndësishme për qytetarët? - Kërkoj që të ndahen subvencione për gratë, që të organizohen panaiere, të cilat do t'i ndihmonin gratë t'i shesin produktet e tyre.	- Kërkesa e pranuar, komuna e Lipjanit do ti shikoj të gjitha mundësit ligjore dhe buxhetore rreth fillimit të procesit të shpronësimit me pronaret e rrugëve në këtë lagje. - Kërkesa e pranuar. Komuna e Lipjanit, vazhdimi ka mbështetur të gjitha iniciativat për sa i përket panaiereve të cilat kanë për qëllim promovimi e produkteve vendore.	F M T 21 5 26	10.06.2025 Salla e Kuvendit Komunal Ora 14:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Gratë dhe shoqatat e grave".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	1. Kërkoj për mundësinë e rritjes së buxhetit për subvencione në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport? 2. Kërkoj sqarim nëse subvencionet janë të ndara sipas kategorive të veçanta? 3. Propozoi ndarjen e një kodi të veçantë buxhetor për riparimin dhe mirëmbajtjen e fushave të hapura sportive në qytet dhe në fshatra? 4. Pyeti nëse subvencionet ndahen në kategori të veçanta apo trajtohen si një kategori e vetme? 5. Kërkoj kategorizimin e klubeve sportive sipas nivelit të garimit, duke e cilësuar të padrejtë ndarjen e barabartë të subvencioneve për të gjitha klubet? 6. Propozoi krijimin e një komisioni vlerësues për të përcaktuar kriteret e ndarjes së mbështetjes? 7. Theksoi se mbështetja aktuale financiare prej 1,500 eurosh është e pamjaftueshme për shkollat e futbollit? 8. Propozoi që në buxhet të parashihen mjete për mirëmbajtjen e lapidarëve? 9. Kërkoj renovimin e sallës "Beterlafi" në Lipjan, si domosdoshmëri për zhvillimin e aktiviteteve sportive në komunitet?	1. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit edhe këtë vit ka rritur buxhetin për subvencione në Drejtorinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit. 2. Sigurisht që subvencionet janë të ndara në kategori të ndryshim siç keni mundur ti shihni edhe thirrjet publike të cilat janë të ndara. 3. Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit aktualisht ka lidhur kontratën për mirëmbajtje dhe në kuadër të saj do të mirëmbahen edhe fushat sportive. 4. Ashtu siç edhe publikohen në thirrjet publik subvencionet janë të ndara për secilën kategori. 5. Kërkesa është pranuar, vazhdimi komuna e Lipjanit ka bërë gradimin e klubeve varësisht nga liga në të cilën është klubi është bërë edhe mbështetja. 6. Kjo është e rregulluar me rregulloren e brendshme të komuna së Lipjanit e cila i ka rregulluar kriteret për mbështetjen. 7. Kërkesa është pranuar sipas buxhetit për subvencione i cili këtë vit ka rritje do të rrite sigurisht edhe mbështetja financiare për shkollat e futbollit. 8. Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit aktualisht ka lidhur kontratën e mirëmbajtjes në të cilën po ashtu është edhe mirëmbajtja e lapidareve.	F M T 2 30 32	10.06.2025 Salla e Kuvendit Komunal Ora 15:30

	9. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit, ka parapa renovimin e sallës Better Life në Lipjan.	
--	--	--



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Organizatrat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive dhe fermerët e Komunës së Lipjanit".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Qytetarët e Lipjanit".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	- Kërkoi përfshirjen e ndërtesave kolektive (banesave në bashkëpronësi) në projektet për efikasitet energjetik, përmes ndonjë granti të mundshëm? - Shtroi nevojën që në projektin për ndërtimin e shtëpisë së kulturës të parashihet edhe ndërtimi i një parkingu nëntokësor në atë zonë, për shkak të mungesës së hapësirave të tilla? - Propozoi hapjen e një çerdheje të re apo kopshti për fëmijë në qytet?	- Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit përmes garantëve nga donatorët do ta shikoj mundësin e përfshirjes së renovimit të ndërtesave kolektive. - Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit ka parapa parkingun nëntokësorë tek shtëpia e Kulturës e cila është duke u ndërtuar. - Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e një çerdheje në qytetin e Lipjanit.	F M T 1 12 13	10.06.2025 Salla e Kuvendit Komunal Ora 16:30




Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Lipjanit".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Qytetarët e Gadimes".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	1. Shtroi nevojën për zgjerimin dhe adaptimin e katër urave në fshat? 2. Propozoi rregullimin e rrugës që lidh Gadimen e Epërme me Gllavicën? 3. Kërkoj rregullimin e shtratit të lumit në një segment që ende nuk është ndërhyrë? 4. Theksoi mungesën e tabelave kufizuese të shpejtësisë në hyrje të fshatit? 5. Kërkoj reagim ndaj kompanisë së ujësjellësit që dëmton rrugët dhe nuk i rikthen ato në gjendjen e mëparshme? 6. Kërkoj riparimin e urës në lagjen Tasholli, ku kabllot janë të ekspozuara? 7. Theksoi nevojën për mirëmbajtjen e barit përgjatë rrugës? 8. Kërkoj asfaltimin e rrugëve që shkojnë drejt gurthyesve? 9. Ngriti nevojën për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe vendosjen e një tabele ndaluese për hedhjen e mbeturinave? 10. Kërkoj rinovimin ose ndërtimin e një palestere të re sportive, për shkak të gjendjes së rënduar të palestrës ekzistuese? 11. Kërkoj asfaltimin e rrugës nga Gadimja – lagja Ejupi deri të rruga për	1. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka parapa investim në ndërtimin e urave në Gadime, Glllogovc dhe Krojmir. 2. Kërkesa është pranuar Komuna e Lipjanit ka parapa rikonstruimin dhe zgjerimin e rrugës Gadime e Epërme – Gllavic. 3. Kërkesa është pranuar Komuna e Lipjanit ka parapa vazhdimin e ndërtimi të lumit në Gadime. 4. Kërkesa është pranuar Komuna e Lipjanit do të vendos shenjat e komunikacionit edhe në rrugët të cilat nuk posedojnë shenja të tilla. 5. Kërkesa pranohet komuna e Lipjanit vazhdimisht dërgon shkresa tek kompania e ujësjellësit për dëmtimin e rrugëve dhe kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme. 6. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e urave në Gadime. 7. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit aktualisht ka lidhur kontratën e mirëmbajtjes dhe aty është edhe pjesa mirëmbajtës së barit përreth rrugëve. 8. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka parapa asfaltimin e rrugicave në Gadime. 9. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit aktualisht	F M T 3 32 35	10.06.2025 Shkolla fillore "Zenel Hajdini", Gadime Ora 19:00

	Samllushë?	ka lidhur kontratën për mirëmbajtjen të ndriçimit publik dhe sigurisht do të vendoste edhe tabela për mos hedhje të mbeturinave. 10. Kërkesa e pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e palestrës së re në Gadime. 11. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e rrugës Gadime deri tek rruga për Samallushë.		
--	------------	---	--	--



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Gadimes".

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme 2026-2028, ka vazhduar më datën 11.06.2025 me banorët e fshatrave Grackë e Vjetër (komuniteti jo shumicë), Dobraj e Madhe dhe Krojmir.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, gjatë takimeve ka bashkëbiseduar me banorët e këtyre lokaliteteve për Kornizën Afatmesme 2026-2028 dhe ka marrë në konsideratë kërkesat dhe prioritetet për të cilat qytetarët e këtyre fshatrave kanë më shumë nevojë, në mënyrë që të përfshihen në planifikimet KAB 2026-2028.

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Qytetarët e Grackës së Vjetër" – komunitetet jo shumicë.

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	1. Të asfaltohet një rrugicë brenda fshatit? 2. Të rregullohen disa drita të prishura në hyrje të fshatit?	1. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka parapa asfaltimin e rrugicave në Grackë të Vogël. 2. Kërkesa është pranuar, përmes kontratës për mirëmbajtje do të rregullohen dritat që janë të prishura.	F M T 0 5 5	11.06.2025 Shkolla fillore në Grackë të Vjetër Ora 17:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Grackës së Vjetër".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Qytetarët e Dobrajës së Madhe".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	1. Kërkoj asfaltimin e rrugicave? 2. Propozoi ndërtimin e një çerdheje? 3. Kërkoj pastrimin e lumit të fshatit? 4. Propozoi subvencionimin e fermerëve lokalë? 5. Propozoi zgjerimin e rrugës në drejtim të Dobrajës së Vogël dhe Medvecit dhe ndërtimin e trotuarit për shkak të qarkullimit të lartë? 6. Kërkoj asfaltimin e disa rrugicave në Dobrajë të Vogël. 7. Propozoi zgjerimin e rrugës që shpie drejt Medvecit?	1. Komuna e Lipjanit ka parapa asfaltimin e rrugicave në Dobrajë të Madhe. 2. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e çerdhes në Dobrajë të Madhe. 3. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit përmes kontratës për mirëmbajte do ti pastroj edhe lumenjtë. 4. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit vazhdimi i përkrah fermerët përmes kategorisë se subvencioneve dhe do të vazhdoj përkrahjen ndaj fermerëve. 5. Kërkesa është pranuar Komuna e Lipjanit ka parapa rikonstruimin e rrugës e cila qon në drejtim të Dobrajës së Vogël dhe Medvecit. 6. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka parapa asfaltimin e rrugicave në Dobrajë të Vogël. 7. Kërkesa është pranuar Komuna e Lipjanit ka parapa rikonstrui e rrugës Dobrajë e Madhe e cila shkon drejt Medvecit.	F M T 5 31 36	11.06.2025 Shkolla fillore "Dy Dëshmorët", Dobrajë e Madhe Ora 18:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Dobrajës së Madhe".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Qytetarët e Krojmirit".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	1. Kërkoj mirëmbajtjen e ndriçimit publik sepse disa drita nuk po bëjnë? 2. Kërkoj rregullimin e kanalizimit sepse po kemi problem? 3. Theksoj se furnizimi me ujë është i pamjaftueshëm dhe kërkoj rritjen e kapacitetit, pasi uji vjen vetëm për një orë në ditë? 4. Kërkoj të ndërtohen urat brenda fshatit?	1. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit përmes kontratës për mirëmbajtje do të rregulloj të gjitha dritat të cilat janë jashtë funksionit. 2. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka parapa rikonstruimin e rrjetit të kanalizimit në Krojmir. 3. Kërkesa nuk mund të pranohet pasi që furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga ujësjellësi e cila nuk menaxhohet nga komuna e Lipjanit. 4. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e urave në Krojmir.	F M T 0 32 32	11.06.2025 Shkolla fillore "Katër Dëshmorët", Krojmir Ora 19:30



Foto



gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Krojmirit".

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e Kornizës Afatmesme për vitet 2026-2028, ka vazhduar me datën 19.06.2025 me anëtarët e Kuvendit, anëtarët e KPF-së, komitetit për komunitet, komitetet tjera, OJQ-të si dhe kryetarët e këshillave të fshatrave.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Daut Azemi, ka organizuar takim me përfaqësuesit institucionalë për Kornizën Afatmesme 2026-2028, ku ka marrë kërkesat dhe prioritetet për planifikimin e buxhetit komunal. Lista dhe procesverbal i takimit të kryesuesit me përfaqësuesit institucional gjenden në sektorin e Kuvendit Komunal.

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2026-2028, me "Anëtarët e kuvendit, Anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komentit për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2026-2028	1. Asfaltimi i rrugës Rubovc Kojске? 2. Mirëmbajtja e sallave sportive? 3. Asfaltimi i rrugës Topliqan Kojске? 4. Rregullimi i ndriçimit publik? 5. Pastrimi i lumit Lluga? 6. Asfaltimi i rrugicave në fshatin Lluga?	1. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka parapa ndërtimin e rrugëve Kojске Rubovc. 2. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit përmes kontratës se mirëmbajtjes në të cilën janë të përfshira edhe mirëmbajtja e fushave sportive. 3. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka prapa asfaltimin e rrugës Topliqan Kojске. 4. Kërkesa është pranuar përmes kontratës se mirëmbajtjes do te rregullohen edhe dritat të cilat nuk janë ne funksion. 5. Kërkesa është pranuar përmes kontratës se mirëmbajtjes do te pastrohen edhe lumenjtë të cilët kanë nevojë për pastrim. 6. Kërkesa është pranuar komuna e Lipjanit ka parapa asfaltimin e rrugicave në fshatin Lluga.	F M T 1 6 7	19.06.2025 Salla e Kuvendi Komunal Ora 14:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Anëtarët e Kuvendit, anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të dhe kryetarët e këshillave të fshatrave".

Konkluzionet

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028 reflekton angazhimin e Komunës së Lipjanit për të përfshirë sa më shumë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në planifikimet e ardhshme buxhetor. Këto takime janë dëshmi e përkushtimit të institucioneve lokale për një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente, duke i dhënë zë grupeve të ndryshme të interesit dhe duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës. Korniza Afatmesme Buxhetore do të aprovohet në Kuvendin e Komunës së Lipjanit dhe më pas do të dorëzohet në Ministrinë e Financave.

Kërkesat e qytetarëve janë nga më të ndryshmet, duke përfshirë investime në infrastrukturë si asfaltimi i rrugicave, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve, shtrirja e ujësjellësit dhe kanalizimeve, si dhe projekte në sektorin e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, kulturës dhe sportit. Nga 46 kërkesa të paraqitura nga qytetarët dhe të shqyrtuara nga komisioni, 43 janë marrë parasysh ose shprehur në përqindje 92.5%, prej tyre janë marrë në konsideratë dhe janë të planifikuara në Kornizën Afatmesme Buxhetore, duke reflektuar përpjekjet e zyrtarëve përgjegjës për të balancuar këto kërkesa me kufizimet buxhetore. Kjo tregon angazhimin për t'i dhënë zë shqetësimeve të qytetarëve, duke garantuar një proces transparent dhe të përgjegjshëm.

Fushat kryesore të kërkesave të pranuara

Infrastruktura rrugore dhe ndriçimi publik – Asfaltimi i rrugicave, ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve kryesore e dytësore, ndërtimi i trotuareve, rikonstruimi i urave dhe përmirësimi i ndriçimit publik në disa zona rurale dhe urbane.

Arsimi – Ndërtimi i një objekti të ri shkollor në qytet, rregullimi i oborreve të shkollave, si dhe parashikimi i çerdheve të reja për fëmijë.

Kultura, rinia dhe sporti – Rritja e buxhetit për subvencione, kategorizimi i klubeve sportive sipas nivelit të garimit, renovimi i sallës sportive “Better Life”, mirëmbajtja e lapidarëve, si dhe planifikimi i ndërtimit të palestrave të reja në disa lokalitete.

Mjedisi dhe shërbimet komunale – Rikonstruimi i kanalizimit, pastrimi i lumenjve, mirëmbajtja e gjelbërimit përgjatë rrugëve, vendosja e tabelave kufizuese të shpejtësisë dhe masat kundër hedhjes së mbeturinave në hapësirat publike.


Zhvillimi ekonomik dhe bujqësia – Vazhdimi i mbështetjes për fermerët përmes subvencioneve, organizimi i panaireve për gratë dhe prodhuesit lokalë, si dhe mundësia e përfshirjes së ndërtesave kolektive në projektet për efikasitet energjetik përmes granteve të donatorëve.

Në anën tjetër, janë identifikuar edhe disa kufizime dhe pamundësi për realizimin e disa projekteve, për shkak të çështjeve pronësore apo kompetencave që ndahen mes niveleve lokale dhe qendrore të qeverisjes. Megjithatë, Komuna e Lipjanit ka shprehur vullnet dhe gatishmëri për të vazhduar përpjekjet në adresimin e këtyre sfidave.

Pjesëmarrja e gjerë në dëgjimet buxhetore dhe përfshirja e grupeve të ndryshme, si dhe konsultimet e hapura me banorët, dëshmojnë rëndësinë e transparencës komunale në proceset vendimmarrëse dhe synimin për të përmirësuar jetesën në nivel lokal. Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028 paraqet një hap të rëndësishëm në zhvillimin e Komunës së Lipjanit, duke adresuar prioritetet e qytetarëve dhe duke krijuar kushte më të mira për mirëqenien e përgjithshme.

Numri i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028 ishte si në vijim: Burra - 165, Gra - 39, Totali - 204 pjesëmarrës nga 9 takimet e realizuara vetëm për Kornizën Afatmesme Buxhetore.

Këtij raporti i janë bashkëngjitur edhe listat e pjesëmarrësve të dëgjimeve buxhetore.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr. 28/14000 Lipjan, Kosovë

Asambleja Komunale, Komiteti për Politikë e Financa, Komiteti për
Komunitete dhe Komitetet tjera

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Fitim Shala	Vrelle e Goleshit	[Signature]
2	Gentiana Haxhaj	Topligun	[Signature]
3	Lulzim Rruste	Lipjan	[Signature]
4	Besiana Sylq	Bernullë	[Signature]
5	Renor Murradi	Korshë	[Signature]
6	Belan Krasniqi	QJ "YAHK"	[Signature]
7	Kimete Jashari	OSCE	[Signature]
8	Fatime Simoni	Aracko e Vjetër	[Signature]
9	BARONYL IBRAHIMI	GLLOGOV	[Signature]
10	FLAMUR SULEJMANI	LELETIQ	[Signature]
11	Jerdian Shala	Lipjan	[Signature]
12	ALBAN BYTYRI	LIPJAN	[Signature]
13	Daut Azemi		[Signature]
14	Imri Semetishiti	DPUM - Lipjan	[Signature]
15	Shehadje Ibrahim	Bursh Financa	[Signature]
16	Laureta Ahmeti	Bursh d/e Financa	[Signature]
17	Edi Ramadani	Dyqen DDF	[Signature]
18	Musa Foxham	Apja	[Signature]
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

10.06.2025

13:30

Gratë dhe shoqatat e Gruas

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Belum Krasniqi	QJQ "YAHK"	<i>[Signature]</i>
2	Mianda Gashi	K.L	<i>[Signature]</i>
3	ARBNORE BERRATONCI	K. 2	<i>[Signature]</i>
4	ALIBAN BYTYRI	LIPJAN	<i>[Signature]</i>
5	Laureta Ahmeti	Lipjan	<i>[Signature]</i>
6	Shchadze Ibrahim	Gadime	<i>[Signature]</i>
7	Gleora Thaqe	Go Vrellë	<i>[Signature]</i>
8	Shefki Pllani	Jeta e Re	<i>[Signature]</i>
9	Fatbardhe Shurdhri	Hallëg i Vosël	<i>[Signature]</i>
10	LINDA SHAHINI	MAGURE	<i>[Signature]</i>
11	Melike Uagimli	Hugakli	<i>[Signature]</i>
12	Emine Mustafa-Deliv	Lipjan	<i>[Signature]</i>
13	VLOKA KRASHICI	Lipjan	<i>[Signature]</i>
14	HYRA BYTYCI	QYLAGË	<i>[Signature]</i>
15	Kimete Tashmari	OSCE	<i>[Signature]</i>
16	Imri Shoborci	Poturoc	<i>[Signature]</i>
17	Elmire Bekuli	Poturoc	<i>[Signature]</i>
18	Safete Amerllahu	Lipjan	<i>[Signature]</i>
19	Desjana Zegiri	Lipjan	<i>[Signature]</i>
20	Magbule Sadiku	Lipjan	<i>[Signature]</i>
21	Ferdan Shala	Lipjan	<i>[Signature]</i>
22	Leurita Haziri	Lipjan	<i>[Signature]</i>
23	Burçake Ahmeti	Rullë	<i>[Signature]</i>
24	Amela Begica	Lipjan	<i>[Signature]</i>
25	Zetra Pymadmiri	Lipjan V-Dogë	<i>[Signature]</i>
26	Ilirija Pajum	Lipjan	<i>[Signature]</i>
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

10.06.2021

04.11.14:30

Organizatat e Shoqërisë Civile, Personat me aftësi të kufizuara, të rinjët, Shoqatat e të rinjëve, Klubet Sportive, Fermeret e Komunës së Lipjanit,

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Belem Krasniqi	ODQ "YABER"	
2	Florim Budakova	Sporti shkalles	
3	Behri Limelli	KLUBI I RINGRANUT "ULPIANA"	
4	Shkodron Retkoceri	KLUBI I HONDBOLLIT "ULPIANA"	
5	TEFIK RETKOCERI	KHF FEMRAT "ULPIANA"	
6	LIPUP BAZUKU	HALLIAQ I "VOGEL"	
7	IMZET LACA	KV SKENDERBEU	
8	SADIK SNAJA	SHKOLLA VOLEJBOLLIT "SKE"	
9	Blerim Duripi	KF ULPIANA 1926	
10	HARIS GRONAJ	SAGORJA CIVILE	
11	GENI FETRI	ULIPJAN	
12	Sherif Bytyqi	AKLLAP	
13	FADIL AHMETI	KFV. LIPIAN.	
14	Gerana Terpeza	LYC	
15	Valmire Marevci	LYC	
16	Kimete Jashanica	OSCE	
17	Ramir Dori	ULPIANA-92 Femt	
18	Hyren Peshkopi	KF ULPIANA 1926	
19	NEXHMEH ZEJNI	BUYER	
20	RASIP MEHMETI	NOBRAJEFEMRAT	
21	Ridvan Uka	GKOGOC	
22	XHAUIT SEJDIU	COLLOGOC	
23	BLERIM RRUSTEMI	BANULLE	
24	Abdullah Hazroviq	MAGURE	
25	JETON GASHI	KF ULPIANA 1926	
26	Ilir Kallaku	SKE	
27	BEKIM ZASKOKA	D. KULTURE	
28	Chen Deniz	D. KULTURE	
29	Anila Derraci	LIPJAN	
30	Jedion Shk	Lipjan	
31	Shk. Pashkova	Lipjan	
32	Imaj Jashanica	Pavise	
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

10.06.2025

15:30

Qyteti i Lipjanit

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Egzon Huredini	Dobrojtë e Madhe	
2	Gent Sylta	Lipjan	
3	Shkelzen Hapke	Lipjan	
4	ALBAN BYTYCI	Lipjan	
5	Belim Krasniqi	070.11.11.11.11	
6	ISKENDER BEPARI	Lipjan	
7	Emir Ahmeti	Lipjan	
8	ERDIN BYTYCI	9.11.11.11.11	
9	Skender Ahmeti	Lipjan	
10	Amir Rexha	Lipjan	
11	Ervin Shala	Lipjan	
12	Lufti Ramadani	Dobrojtë e Madhe	
13	Ilir Ahmeti	Lipjan	
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

10.08.2021

16:30

Gadime

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	BEKIM SHABANI	GADIME EPERME	Shkodër
2	Arben Hyseni	Gadime eperme	Shkodër
3	Mustafë Rrahaj	Gadime eperme	Shkodër
4	Mustafë Rrahaj	Gadime eperme	Shkodër
5	FADIL ALIU	GADIME ULËT	Shkodër
6	BEKIM SHABANI	GADIME EPERME	Shkodër
7	ARBEN HYSENI	GADIME E EPERME	Shkodër
8	Nexhmudin Lelug	Gadime e madhe	Shkodër
9	Abdullë Hyseni	Gadime eperme	Shkodër
10	Mustafë Rrahaj	GADIME E	Shkodër
11	BEKIM KHASANI	GADIME E	Shkodër
12	Sefer Tasholli	Gadime poshtme	Shkodër
13	Bajram Hyseni	Gadime eperme	Shkodër
14	Shed Aliu	Gadime e ulët	Shkodër
15	Fadil Hashani	Gadime e ulët	Shkodër
16	Driton Shabani	Gadime e Eperme	Shkodër
17	Erion Adem	Gadime e Eperme	Shkodër
18	Albiona Tasholli	Gadime e ulët	Shkodër
19	Vendit Agushi	GADIME EPERME	Shkodër
20	FADRI HAMMYTI	GADIME EPERME	Shkodër
21	FATMIR SEJDIU	GADIME EPERME	Shkodër
22	HARBI DEMIRI	GADIME EPERME	Shkodër
23	SHABAN LEKICI	GADIME E ULTE	Shkodër
24	Viktorin Aliu	Gadime	Shkodër
25	Shaban Aliu	Gadime	Shkodër
26	YAKUP TASHOLI	GADIME	Shkodër
27	Shed Aliu	GADIME	Shkodër
28	Granit Gjuri	Gadime	Shkodër
29	Dani Ullari	GADIME	Shkodër
30	Vendit Agushi	GADIME	Shkodër
31	Mustafë Rrahaj	GADIME	Shkodër
32	Donat Hashani	GADIME	Shkodër
33	Muhamet Hashani	GADIME	Shkodër
34	Izudin Rrahmani	GADIME	Shkodër
35	Fatbardha Drenogllava	GADIME E ULËT	Shkodër
36			
37			
38			
39			
40			

10.06.2025

ora 19:00

Grackë e Vjetër (Komunitetet jo shumicë)

Nr	Emri Mbledhësi	Vendi	Nenshkrimi
1	Zoran Cirković	Stara Gracna	3. Kupmud
2	Jovan Matović	Stara Gracna	Matović
3	NASER BYTYRI	Komana	Bytyri
4	ALBAN BYTYRI	LIPJAN	Bytyri
5	ILIRI BERICI	LIPJAN	Bytyri
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

Dobrajë e Madhe

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Burim Reustem	Dobrajë e Madhe	Burim
2	Gentiana Haxhar	Dobrajë e Madhe	Gentiana
3	Besmir Gashi	Dobrajë e Madhe	Besmir
4	Bekim Gashi	Dobrajë e Madhe	Bekim
5	Fatim Breanin	Dobrajë e Madhe	Fatim
6	Elton Llugi	Dobrajë e Madhe	Elton
7	DION LUGI	Dobrajë e Madhe	Dion
8	Leonida Publica	Dobrajë e Madhe	Leonida
9	Emrah Gashi	Dobrajë e Madhe	Emrah
10	Djellaz M. Kalam	Dobrajë e Madhe	Djellaz
11	Gjoni Bytyqi	Dobrajë e Madhe	Gjoni
12	ISHALI UKI	Dobrajë e Madhe	ISHALI
13	Elton Llugi	Dobrajë e Madhe	Elton
14	Elton Llugi	Dobrajë e Madhe	Elton
15	Elton Llugi	Dobrajë e Madhe	Elton
16	Elton Llugi	Dobrajë e Madhe	Elton
17	Leart Halili	Dobrajë e Madhe	Leart
18	PERPARIM SHALA	LUGI	PERPARIM
19	NAZMI KRASNIQI	LUGI	NAZMI
20	Bleart Pllana	Gllanic	Bleart
21	Behar - Arinuri	Dobrajë e Madhe	Behar
22	Besnik Jashari	Dobrajë e Madhe	Besnik
23	Arsim Krasnigj	Dobrajë e Madhe	Arsim
24	NEZIRI GASHI	Dobrajë e Madhe	NEZIRI
25	SAJDI KASARI	Dobrajë e Madhe	SAJDI
26	PEAHIM NEZIRI	DOBRAJE MADHE	PEAHIM
27	RENKOR BASHI	Dobrajë e Madhe	RENKOR
28	Vahim Shohimi	Dobrajë e Madhe	Vahim
29	Shender Gashi	Dobrajë e Madhe	Shender
30	Amila Degera	Dobrajë e Madhe	Amila
31	Safete Amerilahu	Lirija	Safete
32	MEHDI BURUHA	DOBRAJA	MEHDI
33	Devorian Shala	Lirija	Devorian
34	Elton Llugi	Lirija	Elton
35	Lutfi Pashaj	Lirija	Lutfi
36	Ilir Llugi	Lirija	Ilir
37			
38			
39			
40			

11.06.2025
ora 18:00

Krojmir

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	SINANI QERIAI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
2	NORIS QERIGI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
3	TASIM QERIAI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
4	Mymem Qerigji	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
5	Gjergj Olluri	Krojmirë	<i>[Signature]</i>
6	Veton Qerigj	Krojmir	<i>[Signature]</i>
7	Albert Qerigj	Krojmir	<i>[Signature]</i>
8	Fatmir Qerigj	Krojmir	<i>[Signature]</i>
9	HARUT QERIGI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
10	Florian Qerigj	Krojmir	<i>[Signature]</i>
11	PAGIR MAMIKI	Krojmir	<i>[Signature]</i>
12	Gozm Olluri	Krojmir	<i>[Signature]</i>
13	Asben Olluri	Krojmir	<i>[Signature]</i>
14	KIDVAN OLLURI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
15	AMIR QERIGI	040418463	<i>[Signature]</i>
16	Xhemshir Qerigji	Krojmir	<i>[Signature]</i>
17	Hetem Qerigji	Krojmir	<i>[Signature]</i>
18	Vehgi Olluri	Krojmir	<i>[Signature]</i>
19	HAMD QERIGI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
20	Milind Qerigji	Krojmir	<i>[Signature]</i>
21	Driton Rizani	Krojmir	<i>[Signature]</i>
22	Kroni Qerigj	Krojmir	<i>[Signature]</i>
23	ELORIAN QERIGI	Krojmië	<i>[Signature]</i>
24	Jerdion SHYK	Cipër	<i>[Signature]</i>
25	SAMI QERIAI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
26	ISUF QERIAI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
27	MUSTAFA QERIAI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
28	SHKREZIN OLLURI	KROJMIK	<i>[Signature]</i>
29	Geim Olluri	<i>[Signature]</i>	<i>[Signature]</i>
30	Edi Tomadini	Lidzon	<i>[Signature]</i>
31	Vesa Kuthum	Lidzon	<i>[Signature]</i>
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

11.06.2025

ora 18:30

REGJISTRI I PREZENCËS LIDHUR ME DËGJIMET PUBLIKE,PËR PROJKT
BUXHETIN PER VITET 2026-2028 TË MBAJTUR ME 19.06.2025,NË SALLËN
E KUVENDIT ME FILLIM NË ORA 14,⁰⁰

Nr. Ren.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Fadil Sopra Gentiana Hoxhaj Linor Murati Blesrt Pllano Ferdian Shale Behar Alin Davit Arunni Lirid Romandani	Lipjan Tepizan Koskë Glance Ziferr Kopstër V Babush Drift. i DSK	[Signatures]